




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Raporti i monitorimit të ueb faqeve të komunave në rajonin e Mitrovicës

Qershor - Dhjetor 2021

JANAR | 2022



Raporti i monitorimit të ueb faqeve të komunave në rajonin e Mitrovicës

**REC
Mitrovicë, Janar 2022**

Përgatitur nga: Argjenta Kuqi dhe Besnik Uka
Reconciliation Empowering Communities (REC)



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky publikim është prodhuar në kuadër të Aktivitetit për Bashkëpunim në Komunitet, financuar nga USAID, dhe është përgatitur nga REC - Reconciliation Empowering Communities.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	5
Metodologjia.....	6
Platformat e komunikimit me publikun.....	7
Përdorimi i gjuhëve zyrtare gjatë publikimit.....	8
Transparenca e punës së kuvendeve të komunave.....	9
Vendimet e kryetarit të komunës.....	10
Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve.....	11
Rekomandime.....	13

Përmbledhje ekzekutive

Vitet 2020 dhe 2021 sollën vështërsi në funksionimin e institucioneve dhe jetës së përditshme të qytetarëve në përgjithësi si pasojë e pandemisë Covid-19. Detyrimisht po shkohet drejt digjitalizimit dhe shtyrjes së institucioneve lokale dhe qendrore të përshpejtojnë reformat në administratën publike, duke ju mundësuar qytetarëve shërbime sa më cilësore dhe informim publik në kohë reale përmes platformave të komunikimit online. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje si dhe monitorimi i institucioneve komunale janë parime themelore të qeverisjes së mirë për të siguruar transparencë, efikasitet dhe llogaridhënie në proceset demokratike të një vendi.

Ueb faqet zyrtare të komunave duhet të përmbajnë informata për të lehtësuar qasjen në dokumente dhe shërbime për të gjithë, të jenë të përditësuara dhe funksionale.

Të gjitha institucionet publike, lokale apo qendrore obligohen me Kushtetutë të Republikës së Kosovës, dhe një mori ligjesh dhe udhëzimeve administrative si: Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për përdorimin e gjuhëve, Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna, Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike, që t'i publikojnë të gjitha dokumentet zyrtare si dhe për të siguruar qasje në informacion për të gjithë.

Edhe pse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vitin 2018 ka ri-dizajnuar ueb-faqet e 38 komunave në Kosovë, duke mundësuar unifikimin e standardeve të publikimit të informatave publike, dy nga katër komunat që janë monitoruar gjatë kësaj periudhe, nuk kanë ueb faqe zyrtare funksionale! Kjo është tejet shqetësuese për qytetarët pasi që nuk kanë mundësi as një informacion apo dokument ta kenë në formë elektronike/online. Ky raport mbulon monitorimin e ueb-faqeve të komunave në rajonin e Mitrovicës, përkatësisht komunat: Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Skënderaj, gjatë periudhës qershor – dhjetor 2021, dhe pasqyron gjendjen aktuale të institucioneve komunale. Poashtu, raporti ofron rekomandime me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve online dhe nivelit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lokale.

Metodologjia

Metodologjia e ndjekur nga Reconciliation Empowering Communities (REC) për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë një mori aktesh ligjore dhe nënligjore që garantojnë transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike.

Monitorimi i ueb-faqeve zyrtare të komunave: Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Skënderaj, është bërë në baza periodike gjatë periudhës qershor – dhjetor 2021, përfshi fushat përkatëse brenda ueb faqeve zyrtare.

Gjatë periudhës monitoruese, është analizuar dhe konsultuar korniza legjislative si në vijim:

 Ligji Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve;

 Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;

 Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;

 Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;

 Udhëzimi Administrativ të MAP Nr.01/2015 për Ueb faqet e Institucioneve Publike;

 Udhëzimi Administrativ MAPL Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna.

Transparenca, efikasitet dhe llogaridhënia e institucioneve komunale është vlerësuar duke marrë për bazë këta indikatorë:

 Platformat e komunikimit online të komunave me publikun;

 Sa përdoren gjuhët zyrtare gjatë publikimit nga komunat;

 Publikimi i dokumenteve nga komunat në ueb-faqet zyrtare të tyre;

 Publikimi i raporteve dhe vendimeve të kryetarit të komunës;

 Publikimi i raportit të buxhetit dhe shpenzimeve;

 Publikimi i kornizës afatmesme buxhetore 2022-2024;

 Publikimi i njoftimeve për dëgjimet buxhetore;

 Publikimi i rregulltë i raportit 3 mujor financiar.

Platformat e komunikimit me publikun

Gjatë punës disa mujore në kuadër të projektit “Përfshirja e grave dhe të rinjve nga zonat rurale dhe urbane në pjesëmarrjen aktive në dialog dhe politikëbërje në nivel lokal”, OJQ REC është fokusuar edhe në monitorimin online të ueb-faqeve zyrtare të komunave në rajonin e Mitrovicës për periudhën qershor – dhjetor 2021.

Transparenca dhe llogaridhënia online e institucioneve lokale të komunave të Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut, Leposaviq dhe të Skenderajit, konsiderojmë se nuk është e knaqshme karshi qytetarëve.

Sipas udhëzimit administrativ, të gjitha dokumentet publike të komunës duhet të vendosen në ueb faqen zyrtare, në bazë të fushës përkatëse, në mënyrë që të lehtësohet qasja e shpejtë e qytetarit dhe grupeve tjera të interesit.¹



Platformat e komunikimit online me publikun

	Mitrovicë e Jugut ²	Mitrovicë e Veriut ³	Leposaviq ⁴	Skënderaj ⁴
Ueb-faqe zyrtare	✓	✗	✗	✓
Rrjetet sociale	✓	✓	✗	✓

Komunat e Mitrovicës së Veriut dhe ajo e Leposaviqit nuk kanë ueb-faqe zyrtare funksionale, kjo është tejet shqetësuese se si këto dy komuna e as MAPL-ja nuk ndërmarrin hapa që të funksionalizojnë dhe të plotësojnë me informata faqet zyrtare të interentit, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar dhe të kenë shërbime edhe në formë elektronike.

¹ Neni 17.2 Udhëzimi Administrativ MAPL Nr.04/2018 për Transparençën në Komuna

² <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut>

³ <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeeveriut>

⁴ <https://kk.rks-gov.net/leposaviq>

⁵ <https://kk.rks-gov.net/skenderaj>

Përdorimi i gjuhëve zyrtare gjatë publikimit

Për të siguruar një shoqëri shumetnike demokratike, kuadri ligjor i Kosovës siguron mbrojtje thelbësore për të drejtat gjuhësore të komuniteteve të ndryshme dhe detyron institucionet publike të respektojnë përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare.

Ligji për përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal në dokumentet e publikuara në ueb faqet e komunave vazhdon të mos zbatohet, si pasojë e burimeve të pamjaftueshme njerëzore ose mungesës së vullnetit politik. Për shkak të këtyre sfidave të konsiderueshme, qasja në shërbimet publike lokale në gjuhët në përdorim zyrtar për komunitetet jo shumicë në nivel komunal, vazhdon të jetë problematike.

Ligji për përdorimin e gjuhëve në Kosovë i mandaton komunat për të siguruar qasje në informacion për të gjithë, dhe të gjitha dokumentet të publikohen në gjuhët zyrtare.⁶ Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare.



Publikimi në gjuhët zyrtare në ueb faqe

	Njoftimet			
	Mitrovicë e Jugut	Mitrovicë e Veriut	Leposaviq	Skënderaj
Gjuhën Shqipe	✓	✗	✗	✓
Gjuhën Serbe	✗	✗	✗	✗
	Dokumentet			
	Mitrovicë e Jugut	Mitrovicë e Veriut	Leposaviq	Skënderaj
Gjuhën Shqipe	✓	✗	✗	✓
Gjuhën Serbe	✗	✗	✗	✗

Komunat e Mitrovicës së Veriut dhe ajo e Leposaviqit vazhdojnë të kenë ueb-faqet e tyre jashtë funksionit dhe si të tilla nuk kanë mundur të publikojnë në asnjë gjuhë zyrtare njoftimet dhe dokumentet.

⁶ Neni 7 Ligji Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve

Transparenca e punës së kuvendeve të komunave

Kuvendi i komunal duhet të mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryejë përgjegjësitë në kuadër të kompetencave ligjore, në linjë me kornizën ligjore për vetëqeverisje lokale e cila ka përcaktuar disa kritere në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të organeve komunale. Kuvendi i komunës është organi më i lartë përfaqësues i pushtetit lokal dhe njëkohësisht organ i autorizuar ligjërisht për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo mbledhje e kuvendit⁷, thirret nga kryesuesi i cili obligohet që së paku shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe tre (3) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, si dhe brenda ditës në rastet e mbledhjeve urgjente, të njoftojë publikun përmes shpalljes së njoftimit në ueb-faqen zyrtare të komunës, rrjeteve sociale apo mediave.

Gjatë periudhës së monitorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave të Mitrovicës së Jugut dhe të Skenderajit, REC OJQ ka gjetur një dallim të dukshëm në mes të numrit të mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave, me publikimin e procesverbaleve për këto mbledhje në ueb-faqet zyrtare të komunave.

Në krahasim me gjashtë (6) mbledhjet e mbajtura të kuvendit komunal të Mitrovicës së Jugut, vetëm tri procesverbale mund të gjenden të publikuara në ueb-faqe. Edhe kuvendi komunal i Skenderajit ka publikuar vetëm tri procesverbale nga pesë mbledhje të mbajtura gjatë kësaj periudhe të monitorimit.



Publikimi i dokumenteve nga komunat në ueb-faqet zyrtare

	Mitrovicë e Jugut	Mitrovicë e Veriut	Leposaviq	Skënderaj
Thirrjet për mbledhje të kuvendit	6/6	×	×	5/5

⁷ Neni 43 Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Publikimi i procesverbalit nga mbledhjet e kuvendit	3/6	×	×	3/5
Publikimi i vendimeve të kuvendit	31/31	×	×	10/15
Rregulloret që kanë hy në fuqi	2/2	×	×	×

Po ashtu nga praktikat e më hershme e të dy komunave, Mitrovicës së Jugut dhe të Skenderaj, planet e punës së kuvendeve për vitin pasues janë publikuar gjatë muajit dhjetor. Edhe pse inaugurimi i Kuvendeve të Komunave pas zgjedhjeve lokale është bërë në fund të nëntorit 2021, dhe zgjedhja e kryesueseve të Kuvendeve Komunale në Skenderaj⁸ dhe në Mitrovicën e Jugut⁹, planet e punës së kuvendeve për 2022 nuk janë publikuar në ueb-faqet zyrtare.

Vendimet e kryetarit të komunës

Kuvendi i komunës ka të drejtë për të kërkuar raporte dhe llogari nga kryetari i komunës për situatën ekonomike-financiare dhe zbatimin e planeve investuese, së paku një herë në 6 muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi.¹⁰ Në bazë të udhëzimit administrativ për transparencë, raportet e kryetarit duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës bashkë me dokumentet e tjera të obligueshme.

REC OJQ gjatë periudhës së monitorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave të Mitrovicës së Jugut dhe të Skenderajit, nuk ka hasur në asnjë raport të publikuara nga kryetarët e këtyre komunave.

⁸ <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/news/adelina-spahiu-zgjidhet-kryesuese-e-kuvendit-komunal>

⁹ <https://kk.rks-gov.net/mitrovicëejugut/news/vesa-broja-zgjidhet-kryesuese-e-kuvendit-komunal-ne-mitrovicë>

¹⁰ Neni 58 Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale



Publikimi i dokumenteve të kryetarit në ueb-faqet zyrtare

	Mitrovicë e Jugut	Mitrovicë e Veriut	Leposaviq	Skënderaj
Publikimi i raporteve të kryetarit	×	×	×	×
Vendimet e kryetarit të komunës	10/10	×	×	×

Raporti i buxhetit dhe shpenzimeve

Transparenca financiare është një nga kriteret kryesore të qeverisjes së mirë që ndikon në rritjen e llogaridhënies së organeve komunale para qytetarëve.

Në nivelin lokal mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në politikbërje është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Komunitat janë të obliguara të vënë në funksion standarde të ndryshme të diskutimeve publike me qytetarë. Përkundër rëndësisë së këtij procesi, gjendja reale vazhdon të jetë jo e kënaqshme dhe pjesëmarrja e qytetarëve nuk është në nivelin e duhur në dëgjimet buxhetore dhe konsultimet publike. Në përgjithësi arsyet e pjesëmarrjes së ulët lidhen me mosinformimin e duhur të qytetarëve dhe në kohë.

Sipas ligjit, kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit të financave brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i komunës në ueb-faqen e komunës.¹¹

Lidhur me dokumentet financiare komunitat janë të obliguara t'i bëjnë publike planet vjetore buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, njoftimet për dëgjimet buxhetore, raportet 3 mujore financiare, raportet e auditimit etj.

¹¹ Neni 45.4 Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

Gjatë periudhës qershor – dhjetor 2021, REC OJQ ka verifikuar publikimet e dokumenteve nga komunat në ueb-faqet zyrtare si në tabelën në vijim:



Publikimi i dokumenteve financiare të komunave në ueb-faqet zyrtare

	Mitrovicë e Jugut	Mitrovicë e Veriut	Leposaviq	Skënderaj
Planet vjetore buxhetore	×	×	×	×
Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024	1/1	×	×	1/1
Njoftimet për dëgjimet buxhetore	8/8	×	×	12/12
Raporti 3 mujor financiar Prill-Qershor 2021	1/1	×	×	1/1
Raporti 3 mujor financiar Korrik-Shtator 2021	1/1	×	×	×
Raporti 3 mujor financiar Tetor-Dhjetor 2021	×	×	×	×

Ueb-faqet zyrtare të institucioneve publike janë platformat bazë dhe më të aplikueshmet për komunikimin e informatave për qytetarë, dhënen e informacioneve për fushëveprimin e tyre, menaxhimit financiar, aktivitete të prokurimit, si dhe qasje në dokumente publike.

Rekomandime

Me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lokale, përkatësisht të komunave: Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Skënderaj të cilat kanë qenë objekt i monitorimit, Reconciliation Empowering Communities (REC) ka hartuar rekomandimet si në vijim.

Komuna e Mitrovicës së Jugut, duhet të azhurnoj dhe t'i vendos dokumentet me kohë në ueb-faqen zyrtare të saj, siç parashihet me ligj.

Me qëllim të përmirësimit të transparencës të korrigjoj mangësitë dhe të fillojë t'i njohë të gjitha gjuhët zyrtare në përdorim dhe të gjitha dokumentet të publikohen në gjuhët zyrtare në nivel komunal.

Të shtojnë përpjekjet për ndërgjegjësim të të gjitha komuniteteve për të drejtat e tyre gjuhësore dhe t'i përmirësojnë njohuritë gjuhësore të nëpunësve civilë përmes trajnimeve adekuate.

Kryetari i Komunës të jetë më transparent dhe llogaridhënës karshi qytetarëve dhe të publikojë raportin e punës në ueb-faqen zyrtare.

Planet buxhetore dhe raportet financiare të hartohen në mënyrë të detajuar sipas legjislacionit dhe të publikohen me rregull në afatet e parapara në ueb-faqet zyrtare.

Komuna e Mitrovicës së Veriut, duhet sa më parë ta funksionalizoj ueb-faqen zyrtare të saj konform ligjit dhe gjuhëve zyrtare dhe të jetë e qasëshme për të gjithë qytetarët e saj.

Kjo komunë duhet ta shtoj intensitetin e punës në bërjen sa më transparente të aktiviteteve të zhvilluara dhe të gjitha dokumentet të cilat nuk janë publikuar deri më tani në formë elektronike, të bëhen në mënyrë retroaktive.

Kryetari i Komunës të jetë transparent dhe llogaridhënës karshi qytetarëve dhe të respektojë ligjet dhe udhëzimet në fuqi, përfshi publikimin e raportet në ueb-faqen zyrtare.

Komuna e Leposaviqit, duhet sa më parë të funksionalizojë ueb-faqen e saj zyrtare, konform ligjit dhe gjuhëve zyrtare dhe të jetë e qasëshme për qytetarët e atij lokaliteti. Të gjitha dokumentet të cilat nuk janë publikuar deri më tani në formë elektronike, të publikohen në mënyrë retroaktive.

Komuna e Skenderajit, duhet të azhurnojë dhe t'i vendosë dokumentet me kohë në ueb-faqen zyrtare të saj, dhe të gjitha dokumentet të jenë në gjuhët zyrtare siç parashihet me ligj.

Kryetari i Komunës të jetë më transparent dhe llogaridhënës karshi qytetarëve dhe të publikojë raportin e punës si dhe vendimeve në ueb-faqen zyrtare.

Planet buxhetore dhe raportet financiare të hartohen në mënyrë të detajuar sipas legjislacionit dhe të mos neglizhohet publikimi i tyre i rregullt në afatet e parapara, në ueb-faqen zyrtare.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIÇKOG NARODA

Ky raport është mundësuar me mbështetjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është në përgjegjësi të vetme të REC - Reconciliation Empowering Communities dhe nuk paraqet medoemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së SHBA-së.



www.rec-kosova.org

